



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.216/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët, Arsim Hamzaj - kryesues, Kymete Kicaj dhe Skënder Çoçaj - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), e paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për shkak të parregullsisë në ditën e votimit, në Zgjedhjet Lokale 2025, të mbajtura më datë 12 tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 15.10.2025, merr këtë:

V E N D I M

HEDHET e palejuar ankesa ZL.Anr.216/2025 e datës 14.10.2025 e parashtruar nga subjekti Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) e paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për shkak të parregullsive në ditën e votimit për Zgjedhjet Lokale 2025, të mbajtura më datë 12 tetor 2025.

A r s y e t i m

Më datë 14.10.2025, PZAP-i ka pranuar ankesën ZL.Anr.216/2025, të paraqitur nga kandidatja për assemble nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Samire Curri, subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), në të cilën pretendon se më datë 13.10.2025 gjatë komentimit të rezultateve janë vërejtur parregullsi gjatë numërimit të votave për kandidatë për assemble, përkatësisht tek numri 6 dhe numri 3 nga AAK, ku diferenca është 1 vote. Kështu kanë kërkuar rinumërim të votave kandidatëve me numër 6 dhe 3 në të gjitha vendvotimet në Han te Elezit, përkatësisht 3301/01, 3301/02, 3301/03, 3301/04, 3302/01, 3302/02, 3303/01, 3303/02, 2204/01, 3304/02, 3304/03.

Në përgjigjen në ankesë KQZ kanë deklaruar se pas komunikimit me Komisionin Komunal të Zgjedhjeve (KKZ), TW Hanit të Elezit kanë marrë konfirmimin se gjatë procesit të numërimit kanë qenë prezent përfaqësues nga të gjitha subjektet politike, përfshirë edhe

përfaqësues të AAK-së, ku pjesë e ekipit të vëzhgimit ishte edhe motra e parashtrueses së ankesës, e cila në rast të parregullsisë mund të kishte reaguar. Tutje në përgjigje në ankesë theksohet se rezultatet përfundimtare shpallen nga KQZ-ja pas përfundimit të numërimit të të gjitha fletëvotimeve nga vendvotimet e rregullta; fletëvotimet nga votimi me kusht; fletëvotimi nga votimi i personave me nevoja të veçanta; fletëvotimet nga votimi jashtë Kosovës, ku rezultati i publikuar është i ankimueshëm nga subjektet politike dhe kandidatet të cilët kanë pretendime në raport me numërimin e votave. Në përgjigje theksohet se pas rezultateve përfundimtare nga KQZ-ja, palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105 të LZP-së, mund të ushtroj ankesë brenda afatit dyzet e tetë (48) orëve. Tutje, kanë shtuarës i gjithë materiali zgjedhor duke përfshirë edhe kamerat e sigurisë, pas përfundimit të procesit të punës së QKN-së, i njëjti material zgjedhor dorëzohet nga QKN në QNR. Kanë kërkuar nga PZP ta hedh ankesën si të pabazuar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

- Ankesa është e palejuar

Paneli vlerëson se pretendimi i palëve ankuese edhe pse i referohen parregullsisë gjatë numërimit të votave, për shkak se përmes këtyre ankesave atakohet rezultati i cili është ende si rezultat preliminar, e i cili rezultat mund të ndryshoj, ankesa në këtë fazë të procesit zgjedhor është e palejuar-parakohshme, për shkak se pas publikimit të rezultatit përfundimtar i njëjti rezultat është i ankimueshëm nga subjektet politike edhe kandidatët të cilët kanë pretendime në raport me numrin e votave të tyre. Meqenëse në aspektin kohor - faza e procesit zgjedhor kur parashtrohet ankesa është e parakohshme ankesa duhet të hedhet poshtë si e palejueshme.

Në momentin e publikimit të rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja, palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105.1 të Ligji Nr. 08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QKN dhe QNR, dorëzohen me shkrim pranë PZAP-së brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar

Bazuar në arsyet e sipërsënuara dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se *“PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin kriteret e miratuara paraprakisht”* dhe Neni 13 paragrafi 6 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: *“në rastin kur pala ankuese paraqet ankesë për rezultatet preliminare të tabuluara nga KQZ, PZAP-i, me vendim e hedh si të palejuar ankesën”*, andaj lidhur me ankesën e lartpërmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendosja sikurse në dispozitiv të këtij vendimi për hedhjen e ankesave të palejueshme nuk e prejjudikon rezultatit përfundimtar, e po ashtu as të drejtën që palët me të njëjtat pretendime ankimore palët të mund ta atakojnë rezultatit përfundimtar.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së dhe neni 13 paragrafi 6 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
ZL.Anr.216/2025 më datën 15.10.2025

Kryesues i Panelit

Asim Hamzaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.